

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË BORDIT INDUSTRIAL (BI)

Takimi i dytë i Bordit Industrial të FShK

Data:

26.10.2023

Fillimi:

13:30

Përfundimi:

15:00

Lokacioni:

Salla e Senatit, Universiteti i Prizrenit

Pjesëmarrësit:

1. Ziriye Hasani, Dekane e FShK
2. Arbnore Shehu, Sekretare e FShK
3. Enis Qafëleshi, Makerspace – Kryetar i BI
4. Esen Kaymakci, Eris Agensi Prizren
5. Marigona Krasniqi, Vista
6. Lulzim Guhelli, Ex-Cite
7. Visar Haxhifazliu, ITP Prizren
8. Naim Baftiu, prodekan në FShK
9. Nehat Gashi, Koordinator i Qendrës së Karrierës dhe Alumni
10. Arta Rrustemi, u.d. Udhëheqëse e Aktivitetit
11. Ariel Shaban, Specialist i Marrëdhënieve me Industrinë
12. Cassie Barnhardt, Drejtore e Aktivitetit *Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education*
13. Zoie Schares, Menaxhere e Lartë e Aktivitetit
14. Ardi Mejzini, Menaxher i Komunikimit
15. Getoar Krasniqi, Specialist i ICT
16. Denur Paçaku, Asistent i Programit

PËRSHKRIMI I TEMAVE TË TRAJTUARA DHE KONKLuzionET

I) Diskutim në BI

- Ziriye Hasani prezanton programin studimor Softëare Design Professional. Pas prezantimit të lëndëve të programit të studimeve kërkon të shoh nëse ka ndonjë koment nga kompanitë private.
- Në vitin akademik 2023/24 mbi 100 studentë kanë mbetur pa u regjistruar në studime.
- Lulzim Guhelli tha se programi është i qëlluar, është edhe për tregun e jashtëm, meqë shumica e shërbimeve të cilat ne i kemi këtu janë out-source. Programi nuk është vetëm për treg të Kosovës, kjo është e mirë.
- FShK i ka pasur 13 studentë praktikantë në Innovation and Training Park (ITP) Prizren, dhe pas punës praktike 50% e tyre janë punësuar.
- Lulzim Guhelli tha se çështjen e programit të studimeve duhet ta diskutojmë në një takim të veçantë, ku do të takohenim e të flasim më gjerë se si do të mund të rregullohej kjo pjesë.
- Nehat Gashi pyet se a mendoni që programi i studimeve do të jetë profesional apo shkencor. Për këtë, Ziriye Hasani iu përgjigj duke thënë se është profesional dhe se pozitat e lira në treg janë më shumë të lira në profesional.
- Sa i përket punës praktike, Naim Baftiu, thotë se e kemi menduar të kemi memorandum të bashkëpunimit me kompanitë, edhe pse në aspektin profesional mendon se ajo duhet të jetë praktikë mbi 6 muaj.
- Lulzim Guhelli mendon se ky program i studimeve në studimet bachelor duhet të jetë shkencor dhe në studimet master duhet të jetë profesional.
- Ziriye Hasani thotë se ka pasur raste që janë punësuar studentët pas vizitave studimore të cilat i kanë bërë. Lidhur me këtë, Enis Qafëleshi thotë se shumica e kompanive vendore e “shesin trurin”, pra kemi të bëjmë me outsourcing dhe outstaffing.
- Sipas Ziriye Hasanit, qëllimi kryesor është të zhvillohen aftësitë programuese.

- Dekanja Albana Milaimi tha se kompanitë private nuk marrin pjesë në BI, shkaku i asaj që ata ndonjëherë nuk kanë kohë meqë janë të angazhuar me punë. Më pas, veç kësaj, arsye tjetër është edhe largësia e pjesëmarrësve në bord nga vendi se ku mbahet dhe mungesa e incentivave.
- Besim Loshaj tha se ftesat duhet t'i dërohen drejt pronarëve të kompanive (p.s. kjo është ajo që veç e kemi bërë). Ka nga punëtorë nga kompanitë të cilët nuk kanë kualifikim apo qasje për probleme të ndryshme. Ai thotë se kompanitë kanë më shumë përqëndrim në profit.
- Besim Loshaj thotë se ka rëndësi që të krijohet një vetëdije apo të mërret një model p.sh. nga shtetet e perëndimit për atë se si funksionojnë BI, apo programet përkatëse.
- Evelina Leka mendon se bizneseve/ kompanive private duhet t'i jepet një lëvdatë/ falënderim për kontributin e tyre.
- Albana Milaimi propozoi ndonjë incentivë, pagesë e rrugës apo mëditje për kompanitë private.
- Besim Loshaj mendon se jo çdonjëri e kupton qëllimin e BI. Ai tha se është mirë që të takohet dikush me pronarët e kompanive dhe t'ua sqarojë se jo gjithçka është materiale dhe se është me rëndësi të marrin pjesë kompanitë private.
- Ariel Shaban thotë se është rritur regjistrimi/ interesimi për studimet në fushën e bujqësisë në Universitetin e Pejës, arsyeja se ata e dinë se pas studimeve kanë mundësi më të madhe të pësnohen.

II) Corporate Panels

- Cassie Barnhardt dhe Ardi Mejzini e përmenden se nga shkurti i vitit të ardhshëm fokus do të ketë edhe në softëare engineering.
- Getoar Krasniqi prezantoi detaje rreth organizimit të Trajnimit të Trajnerëve dhe Corporate Panels.
- Ariel Shaban e përmendi se profili i pjesëmarrësve në Panelët Korporative është i nivelit të mesëm.

III) Prezantimi i të dhënave preliminare nga hulumtimi

- Në vazhdim të diskutimit, Getoar Krasniqi prezantoi të dhëna preliminare të hulumtimit të cilat kishin të bëjnë me numrin e studentëve të regjistruar e aktivë.
- Softëare është outsource më i madh: softëare dhe eeb developer.
- Një e dhënë që u diskutua më shumë është: 7200 studentë aktivë në të gjitha universitetet publike dhe private në fusheën e ICT dhe të diplomuar vetëm 760. Ky numër fillimisht u duk se paraqet një problem serioz, por duke konsideruar që ajo përfshin tre vite akademike të studimeve, pra një numër më të madh të studentëve, nuk është se paraqet ndonjë trend tejet negativ.
- Lulzim Guhelli thotë se mbi të dhënat ka shumë pikëpyetje.
- Enis Qafëleshi thotë se duhet të shihen në mënyrë progresive.

IV) Prezantimi nga Qendra e Karrierës dhe Alumni

- Nehat Gashi prezantoi për funksionimin e Qendrës së Karrierës dhe Alumni dhe raportin e saj me universitetin dhe kompanitë private.
- U prezantua puna e zyrës, trajnimet, forma, pjesëmarrësit dhe organizimi i start-up-eve.
- Bashkëpunimi i zyrës me BI ka qenë sipërfaqësor.
- Nehat Gashi tha se është vetëm një person që punon në zyrë dhe është pak sa e vështirë për të. Në vijim të këtij diskutimi, Cassie Barnhardt tha se këtë punë p.sh. në USA do ta kryenin 12-15 punëtorë. Ndërlidhur me këtë, ajo e përmendi se në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të aktivitetit dhe Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" (UPZ), do të punësohet edhe një punëtor në Qendrën e Karrierës dhe Alumni.
- Nehat Gashi thotë se tentojmë të marrim të dhëna për punësimin e studentëve, të shohim se çfarë po punojnë aktualisht ata dhe a ka nevojë për ndryshim të orientimit në treg.
- Enis Qafëleshi pyet Cassie Barnhardt nëse projekti parsheh ndonjë mbështetje për Qendrën e Karrierës dhe Alumni. Për këtë, Cassie Barnhardt thotë se parashihen mentorë nga loëa, për Qendrën e Karrierës dhe Alumni në UPZ.
- Një statistikë e veçantë që u nda është se 63% e studentëve të UP nuk i shfrytëzojnë resurset nga Qendra e Karrierës.

- Qendra e Karrierës dhe Alumni në UPZ, mban javë të mirësearchjes për studentët e rinj dhe i informon ata për funksionimin e zyrës.

V) Kosvova Learn

- Ardi Mejzini prezantoi platformën Kosvova Learn dhe mundësitë që ofrohen për studentët.
- U njoftuan të pranishmit për sesionet e mbajtura të informimit të studentëve sa i përket platformës.
- Lulzim Guhelli propozoi që të shihet mundësia e inkuadrimin të Kosvova Learn në SEMS, si mundësi më e mirë për arritjen e një numri më të madh të studentëve.
- Në fund të takimit u diskutua për mbajtjen e takimit të tretët të radhës të BI.

AKTIVITETE TË PLANIFIKUARA (NËSE KA)

AKTIVITETI		PËRGJEGJËSIA	AFATI I FUNDIT

Denur Paçaku

Pogram Assistant,
 Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education,
 USAID Grantee,
 Iowa Consortium, University of Iowa,
 Prizren, Kosovo, 20 000 (GMT +2),
 Mobile: +383 48 265 012.

IOWA